

UDHËZIM
Nr.3, datë 13.9.2006

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E ANKANDIT TË SHITJES SË MATERIALIT
DRUSOR TË ASORTUAR E TË MAGAZINUAR NË ANË TË RRUGËS**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës IV/8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.394, datë 21.06.2006 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Asortimentet e gatshme, të prodhuara dhe të stivosura në anë të rrugës apo në sheshe depozitimi nga subjektet private për llogari të entit shitës (Drejtorisë së Shërbimit Pyjor DSHP), shiten me ankand.

2. Me ankand shiten edhe assortimentet e prera ilegalisht dhe të sekuestruara nga strukturat e shërbimit pyjor dhe institucione të tjera shtetërore, jashtë ngastrave apo nënngastrave pyjore. Në këtë rast procesverbali i sekuestrimit është pjesë përbërëse e dokumenteve të ankandit.

3. Ankandi bëhet i hapur për çdo parti assortimentesh, ose për të gjitha partitë e të njëjtit assortiment që i përkasin të njëjtës cilësi dhe të njëjtit lloj drusor.

4. Procedura e shitjes duhet të garantojë të drejtën e barabartë të konkurruesve për të konkurruar, administrimin e mirë e rigoroz të mallit të dhënë në dispozicion nga organi shtetëror si dhe synon të mos lejojë diskriminimin e konkurruesve.

KREU II
PËRGATITJA E ANKANDIT

1. Përgatitja dhe zhvillimi i ankandit në përputhje me kërkesat ligjore, është përgjegjësi e drejtorive të shërbimit pyjor në rrethe.

2. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të ankandit përcaktohen me urdhër të drejtorit të DSHP. Në të njëjtin urdhër përcaktohet përbërja e komisionit të përgatitjes së dokumenteve të ankandit dhe e komisionit të zhvillimit të tij.

3. Komisioni i zhvillimit të ankandit, i cili duhet të përbëhet nga 5 persona, ndër të cilët rekomandohet zëvendëstitullari, drejtuesi i sektorit financiar dhe tre specialistë të kualifikuar sipas objektit të shitjes. Drejtuesi i komisionit zëvendësohet vetëm në raste të veçanta dhe për arsye objektive.

4. Komisioni përcakton kriteret e vlerësimit paraprak që lidhen me plotësimin e dokumentacionit dhe respektimin e kushteve të parashikuara në ftesën e ankandit, si dhe kriterin e vlerësimit ekonomik, që, pavarësisht nga sasia, përparësi në vlerësim do të kenë ofertat, duke filluar me çmime më të larta dhe deri në ato me çmime të barabarta me çmimin fillestar të shitjes të vendosur nga enti shitës. Kriteret e vendosura shpallen nga komisioni qysh në fillim të procedurës së ankandit.

5. 15 ditë para datës së zhvillimit të ankandit, bëhet njoftimi për ditën, vendin dhe orën e zhvillimit të tij. Njoftimet bëhen nëpërmjet radiove e televizioneve lokale, gazetave lokale, si dhe të afishimeve të ndryshme në qendër të drejtorisë, në qytete dhe qendrat e komunave të rrethit ku do të zhvillohet ankandi.

6. Me shpalljen e datës së ankandit, në një vend të dukshëm të territorit të zyrave të drejtorisë, afishohen lista e asortimenteve që do të shiten sipas llojeve, vëllimi në m³, të shoqëruar me destinat përkatëse, sipas cilësisë së tyre, si dhe vëllimi i asortimenteve, që maten me mst. Gjithashtu, njoftohet vendndodhja e asortimenteve të stivosura e të nxjerra për shitje.

7. Komisioni përgatit njoftimin dhe e shpall atë sipas pikës (II-5), të cilit i vihet një numër referimi. Njoftimi përmban adresën e entit shitës, listën e asortimenteve që do të shiten sipas llojeve,

vëllimi në m³, të shoqëruar me destinat përkatëse sipas cilësisë së tyre, si dhe vëllimi i asortimenteve, që maten me mst. Gjithashtu, njoftohet vendndodhja e asortimenteve të stivosura e të nxjerra për shitje (nr. i ngastrës/nënngastrës dhe ekonomia pyjore), ku dhe si do të sigurohen dokumentet e ofertës së ankandit, afatin e fundit të paraqitjes së ofertës, vendin, datën dhe orën e hapjes së zarfeve të ofertave, si dhe pjesëmarrjen në hapjen e tyre.

8. Konkurruesve u mundësohet njohja vetë fizikisht me mallin objekt i shitjes me ankand.

9. Komisioni përgatit dokumentacionin e ankandit në përputhje me anekset, pjesë përbërëse të këtij udhezimi.

10. Dokumentacioni i ankandit i përgatitur nga komisioni u dorëzohet konkurruesve që paraqiten në bazë të njoftimit të bërë nga enti shitës.

11. Çmimi fillestar i lëndës drusore të asortuar, sipas ngastrave apo n/ngastrave, do të jetë i barabartë me koston e prodhimit (shpenzimet e prodhimit + tarifën bazë të lëndës drusore më këmbë) dhe normën e fitimit për njësi në masën jo më të vogël se 15 %. Në këtë çmim minimal nuk është përfshirë TVSH. Norma e fitimit do të jetë në raport me largësinë e materialit drusor nga vendi i prodhimit apo sheshi i depozitimit në qendrën e DSHP.

KREU III ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Në ankand marrin pjesë të gjitha subjektet juridike e fizike të tregtimit dhe të përpunimit të lëndës drusore që janë të interesuara për lëndën drusore të nxjerrë në ankand.

2. Në dokumentet e kualifikimit të paraqitura nga subjektet, nuk lejohen mangësi, paqartësi dhe korrigjime në të dhënat që ata përmbajnë.

3. Ankandi zhvillohet për sasinë e prezantuar të çdo asortimenti ose të partisë së asortimentit, sipas llojit dhe cilësisë respektive.

4. Në ankand personi juridik ose fizik përfaqësohet nga administratori ose nga një person tjetër i pajisur me prokurë.

5. Kryetari i komisionit të zhvillimit të ankandit, mbas prezantimit të anëtarëve të komisionit, kërkon dorëzimin e zarfave nga subjektet pjesëmarrëse në ankand.

6. Oferta duhet të paraqitet me një zarf, i cili duhet të jetë i mbyllur dhe i vulosur. Në anën e përparme të tij duhet të shkruhet adresa e entit shitës, numri i referencës së njoftimit dhe brenda të ketë dokumentin e ftesës së ankandit, formularin e ofertës së ankandit (sipas anekseve bashkëlidhur) dhe dokumentin bankar të lëshuar nga dega e bankës së konkurruesit. Të gjitha dokumentet duhen të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga titullari i firmave konkurruese. Nëse zarfi nuk është i vulosur ose nuk ka të shënuara kërkesat e përmendura më sipër, enti shitës nuk mban përgjegjësi për eliminimin e ofertës.

7. Konkurruesi ka të drejtë të kërkojë sqarime me shkrim për formën dhe përmbajtjen e ofertës që do të paraqesë, si dhe të dokumenteve të tjera që i kërkojnë, deri në 5 ditë para afatit të fundit të pranimit të ofertave. u kthehen menjëherë e të pahapura konkurruesve.

8. Zarfet që mbërrijnë më vonë se data e caktuar, regjistrohen dhe u kthehen menjëherë e të pahapura konkurruesve.

9. Për raste të veçanta, kur në datën e caktuar nuk paraqitet asnjë ofertë, komisioni mund të vendosë e shpallë në të njëjtin organ ku ka bërë njoftimin shtyrjen e afatit të fundit të pranimit të ofertave deri në 5 ditë. Nëse edhe në afatin e ri nuk paraqitet ndonjë ofertë, komisioni duhet të përmirësojë dosjen e ankandit dhe të rifillojë procedurën nga e para.

10. Zarfet hapen nga komisioni në ditën, orën dhe vendin e caktuar, të njoftuar që në fillim të procedurës së ankandit.

11. Në seancën e hapjes së zarfeve, përveç komisionit, marrin pjesë dhe përfaqësues të konkurruesve, duke paraqitur autorizimin përkatës.

12. Shqyrtimi i ofertave të regjistruara bëhet menjëherë, siç është vendosur dhe shpallur më parë në njoftim. Shqyrtimi bëhet në dy faza:

a) Faza e parë është shqyrtimi paraprak dhe ka të bëjë me shqyrtimin e dokumenteve, formën e paraqitjes së tyre etj. Këto nuk janë në përputhje me rregullat dhe kriteret e shpallura, oferta përjashtohet nga konkurrimi i mëtejshëm. Për këtë fazë përgatitet me shkrim raporti i hapjes së ofertave për gjithë konkurruesit.

b) Faza e dytë është shqyrtimi ekonomik, ku analizohen sasitë, çmimet, verifikohen vleftat etj.

13. Ofertat e vlerësuara si të rregullta pas shqyrtimit paraprak krahasohen ndërmjet tyre sipas vlerësimeve të fazës së dytë dhe klasifikohen. Për këtë fazë (b) përgatitet me shkrim raporti i vlerësimit të ofertave për çdo konkurrues. Oferta që konsiderohet më e mirë, shpallet fituese dhe afishohet në entin shitës.

14. Në rast se konkurruesi që ka fituar nuk pranon dhe tërhiqet nga ankandi, kjo dokumentohet dhe fituese shpallet oferta e çmuar si e dyta më e mirë. Sigurimi i ofertës fituese që tërhiqet konfiskohet.

15. Pas shpalljes së konkurruesit fitues, enti shitës lidh me të kontratën, përgatit autorizimin (duke pasur bashkëlidhur emrin e konkurruesit fitues të ankandit) dhe e dërgon menjëherë në llogarinë bankare të blerësit, duke kërkuar që blerësi të bëjë pagesën, sipas dokumentit bankar të lëshuar nga banka për ata konkurrues, në llogarinë bankare të entit shitës.

16. Pas paraqitjes së dokumentit nga dega e bankës së blerësit për pagesën e bërë prej tij, enti shitës autorizon për fillimin e shpërndarjes së materialit.

17. Dosja e plotë e dokumenteve të ankandit ruhet nga enti shitës. Në të nuk lejohen korrigjime dhe mund t'u jepet për shqyrtim vetëm personave që autorizohen nga titullari i entit shitës.

18. Komisioni mund ta anulojë ankandin, kur:

a) Asnjë ofertë nuk kënaq kushtet ekonomike të kërkuara.

b) Të gjitha ofertat përmbajnë parregullsi thelbësore që e pengojnë shqyrtimin normal të tyre.

19. Nëse kërkesa është bërë për sasi më të vogël se ajo e prezantuar, ajo nuk merret në konsideratë dhe konsiderohet mosplotësim i një prej kushteve të ankandit.

20. Ofertat ekonomike të secilit subjekt u prezantohen pjesëmarrësve. Nëse të gjitha ofertat janë nën çmimin e caktuar sipas asortimenteve, ato refuzohen dhe ankandi anulohet. Nëse nga të gjitha ofertat vetëm njëra është e barabartë ose më e madhe se çmimi i caktuar, ajo shpallet fituese. Nëse dy ose më shumë oferta janë oferta mbi çmimin e caktuar, fitues shpallet oferta me vlerën më të madhe. Mbas shqyrtimit të të gjitha ofertave, përpilohet procesverbali, ku pasqyrohen të gjitha ofertat e paraqitura dhe firmoset nga anëtarët e dy komisioneve.

21. Për subjektin që shpallet fitues, përpilohet procesverbali, ku shënohen asortimentet e fituara, sipas llojit, cilësia, sasitë si dhe vlefta totale. Procesverbali, në dy kopje firmoset nga palët dhe një kopje qëndron në DSHP, ndërsa tjetra i jepet subjektit fitues.

22. Për subjektet, që nuk shpallen fitues, DSHP, brenda 15 ditëve njofton bankat për zhbllokimin e garancisë bankare për sigurimin e ofertave. Brenda të njëjtës periudhë, ajo njofton bankat për zhbllokimin e garancisë bankare, për sigurimin e ofertave të subjekteve, që janë shpallur fituese, të cilat janë të detyruara të bëjnë sigurimin e kontratës, në masën 10 % të vlerës, me të cilën janë shpallur fituese të ankandit.

23. Garancia bankare për sigurimin e kontratës qëndron e ngurtësuar 30 ditë mbas datës së përfundimit të kontratës. Brenda kësaj periudhe, nëse subjekti nuk ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj DSHP, kjo e fundit i kërkon bankës kalimin e vlerës së ngurtësuar në llogarinë e saj dhe në të kundërt lirim e kësaj vlere në favor të subjektit.

24. Mbas nënshkrimit të procesverbalit, DSHP i dorëzon subjektit me shkresë zyrtare, kontratën në dy kopje, të cilat subjekti duhet t'i firmosë dhe njëërën prej tyre ta dorëzojë brenda 3 ditëve nga data e marrjes, së bashku me garancinë bankare për sigurimin e saj. Brenda kësaj periudhe palët mund të negociojnë në frymën e këtij udhëzimi, rreth detajeve dhe problemeve të tjera, të parashikuara në kontratë.

25. Kur subjekti nuk kthen kontratën e firmosur, së bashku me garancinë bankare për sigurimin e saj, brenda 3 ditëve, DSHP i kërkon bankës kalimin në llogarinë e saj të vleftës së ngurtësuar prej tij, për sigurimin e ofertës. Njëkohësisht atij i hiqet e drejta e pjesëmarrjes në ankandet e tjera për një vit.

26. Brenda 5 ditëve nga data e skadimit të afatit për lidhjen e kontratës, DSHP fton subjektin që renditet i dyti, të lidhë kontratën, me kusht që çmimet e ofruara prej tij të jenë më të mëdhenj ose të barabartë me çmimet e referencës, në të kundërt, ankandi anulohet.

27. Për materialin drusor të blerë, subjekti bën pagesën 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Për asortimentet drusore, deri 200 m³, pagesa bëhet njëherësh dhe mbi 200 m³ me dy këste. Afati maksimal i pagesës së kështit të dytë, është 15 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës. Pagesa për asortimentet e sekuestruara bëhet njëherësh. Çdo pagesë bëhet me vlerën e plotë, sipas kësteve të

vendosura në kontratë.

28. Për çdo ditë vonesë në likuidimin e detyrimeve kontraktore, subjekti detyrohet të paguajë kamatëvonesë në masën 0,1 %, të vlerës së kështit përkatës.

29. Me nënshkrimin e kontratës DSHP çlirohet nga çdo përgjegjësi për ruajtjen dhe dëmtimet që mund të pësojë materiali drusor i shitur.

30. Subjektet që kanë pretendime rreth ankandit dhe rezultateve të tij, mund t'i paraqesin ankesë me shkrim Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, brenda 3 ditëve nga data e zhvillimit të tij, duke vënë në dijeni njëkohësisht DSHP për këtë ankesë.

31. Me marrjen e njoftimit nga subjekti për ankesën e tij, DSHP pezullon të gjitha veprimet për lidhjen e kontratave, deri në marrjen e përgjigjes përkatëse.

32. Subjekti merr përgjigje brenda 10 ditëve nga data e protokollimit të ankesës së tij dhe ajo është e formës së prerë. Për përgjigjen, vihet në dijeni edhe DSHP, ndaj së cilës ishte ankesa, si dhe udhëzohet për veprimet e mëtejshme që duhet të kryejë.

33. Brenda 30 ditëve pas përfundimit të ankandit, dosja me gjithë dokumentacionin e tij, sistemohet dhe dorëzohet në protokoll nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

34. Kur ankandi nuk arrin të realizohet, sepse nuk ofrohen blerësit, anulohet apo shpallet i pavlefshëm për mosrespektim të kërkesave ligjore, organizohet ankandi i ri brenda afateve të lejuara, deri sa të realizohet shitja e materialit drusor.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave dhe DSHP-të në rrethe.

2. Anekset bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

Aneksi Nr.1

DOKUMENTET STANDARDE PËR PROCEDURAT E ANKANDEVE NË DSHP

Përmbajtja :

1. Ftesa për ankand.
2. Kriteret dhe kushtet e përgjithshme për konkurruesit në ankand.
3. Përshkrimi i objektit konkret të shitjes me ankand.
4. Formulari i ofertës për ankand për konkurruesit person fizik / juridik.
5. Formulari i sigurimit të ofertës:
 - i) lëshuar nga bankat;

- ii) lëshuar nga shoqëri sigurimi;
- 6. Formulari i sigurimit të kontratës:
 - i) lëshuar nga bankat;
 - ii) lëshuar nga shoqëri sigurimi;

Komisioni i shitjes me ankand
Datë më ____/____/200__

FTESË PËR ANKAND

Drejtoria e Shërbimit Pyjor e rrethit _____ fton individët, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj për të marrë pjesë në ankand për shitjen e _____ (lloji, sasia e mallit dhe disa të dhëna të përgjithshme mbi mallin në shitje).

Të interesuarit mund të tërheqin dokumentet e ankandit pranë sektorit të _____ Drejtorise së Shërbimit Pyjor, me adresë: “ _____”, Tel. 355 _____, Faks: 355 _____, kundrejt një pagese prej _____ lekë.

Hapja e dokumentacionit do të bëhet në datë _____.____.200_, ora _____ në adresën e mësipërme. Dërgimi i ofertës mund të bëhet duke dërguar zarfin me postë ose edhe me paraqitjen e vetë konkurruesve apo të përfaqësuesve të tyre të autorizuar në adresën e mësipërme.

Mënyra e dorëzimit të dokumenteve dhe e vlerësimit të tyre do të bëhet sipas përcaktimeve të bëra në kriteret dhe në kushtet e përgjithshme për konkurruesit në ankand, pjesë e këtyre dokumenteve ankandi.

Për DSHP e rrethit _____

Kryetari i komisionit të shitjes me ankand

KRITERET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR KONKURRUESIT NË ANKAND

Drejtoria e Shërbimit Pyjor _____ ju fton për të konkurruar në ankandin për shitjen _____ (lloji, sasia e mallit) sipas përcaktimit në ftesën për ankand dhe në përshkrimin e objektit konkret të shitjes me ankand, pjesë përbërëse e këtyre dokumenteve të ankandit)

1. Pronësia e mallit :Në pronësi të DSHP _____.

2. Gjuha e ofertës dhe çmimi i shitjes : Gjuha e ofertës do të jetë gjuha shqipe dhe çmimi i shitjes së mallit nga konkurruesi duhet të jepet në lekë [1] [1]

3. Çmimi minimal i shitjes së mallit: Çmimi minimal i shitjes së mallit është _____ lekë. [2] [2]

4. Shpjegimi i dokumenteve dhe njohja fizike e mallit objekt i shitjes: Çdo konkurrues ka të drejtë të kërkojë sqarime me shkrim për formën dhe për përmbajtjen e ofertës që do të paraqesë, si dhe të dokumenteve të tjera që i kërkojnë, deri në 5 ditë pune para afatit të fundit të pranimit të ofertave dhe komisioni është i detyruar t'i kthejë përgjigje brenda 3 ditëve pune nga marrja e kërkesës.

Konkurruesve u jepet mundësia që më datë _____.200__, nga ora ____ deri në orën _____ të shohin vetë fizikisht mallin objekt i shitjes me ankand.

5. Shtesa dhe ndryshime në dokumentet e ankandit: DSHP _____ mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit përpara datës së caktuar për hapjen e tij. Këto ndryshime u njoftohen me shkrim të gjithë konkurruesve. Në rast se gjykohet e arsyeshme, komisioni mund të shtyjë afatin e hapjes së ankandit brenda një kohe që ky komision e gjykon të mjaftueshme për përgatitjen e saktë të ofertave.

6. Vlefshmëria e ofertës: është minimumi _____ ditë.

7. Sigurimi i ofertës: Çdo konkurrues duhet të paraqesë sigurimin e ofertës në shumën prej _____. Mosparaqitja e dokumentit të sigurimit të ofertës apo paraqitja jo sipas përcaktimit të bërë në formularin e sigurimit të ofertës, pjesë e këtyre dokumenteve të ankandit përbën kusht skualifikues. Sigurimi i ofertës konfiskohet nga DSHP e rrethit _____, në rast se një konkurrues tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertës ose në rastin e një konkurruesi fitues, i cili heq dorë nga lidhja e kontratës ose nga pagimi i çmimit të shitjes. Gjithashtu, DSHP e rrethit _____ do të konfiskojë sigurimin e ofertës, nëse në rast gabimi aritmetik, një pjesëmarrës nuk pranon të korrigjojë ofertën e tij.

Sigurimi i ofertës për konkurruesit çlirohet pas shpalljes së fituesit, ndërsa sigurimi i ofertës për fituesin çlirohet pas pagimit të çmimit të shitjes.

8. Procedura e hapjes së ankandit dhe e vlerësimit të ofertave : Ankandi (hapja e zarfeve nga komisioni) hapet në ditën, në orën dhe në vendin e caktuar. Ofertat (zarfet) që mbërrijnë më vonë se afati i caktuar, regjistrohen dhe u kthehen menjëherë e të pahapura konkurruesve.

Konkurruesi në ankand, mund të paraqesë vetëm një ofertë sipas objektit të shitjes dhe përcaktimeve në dokumentet e ankandit. Oferta duhet të paraqitet me një zarf, i cili duhet të jetë i mbyllur. Në anën e përparme të tij duhet të shkruhet adresa: DSHP e rrethit _____, Komisioni i Shitjes me Ankand dhe brenda tij të ketë formularin e ofertës së ankandit, si dhe dokumentet e kërkuara për fazën e vlerësimit paraprak, në dokumentacionin e ankandit.

[2] [2]Në rast se është përcaktuar një çmim i tillë në urdhrin përkatës për zhvillimin e ankandit.

Formulari i ofertës për ankand, pjesë e dokumenteve të ankandit, duhet të jetë i nënshkruar nga konkurruesit (për firmat konkurrese, të nënshkruara dhe të vulosura nga titullari përkatës). Nëse nuk plotësohen kriteret dhe kërkesat e mësipërme, oferta skualifikohet dhe nuk merret në konsideratë.

Në seancën e hapjes së zarfeve, përveç komisionit, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të konkurruesve.

Shqyrtimi i ofertave bëhet në dy faza:

Faza e parë është shqyrtimi paraprak dhe ka të bëjë me shqyrtimin në vend, në prani të konkurruesve të dokumenteve, të formës së paraqitjes së tyre etj. Kur këto nuk janë në përputhje me rregullat dhe me kriteret e përcaktuara në këto dokumente ankandi, oferta përjashtohet nga konkurrimi i mëtejshëm.

Faza e dytë është ajo e shqyrtimit ekonomik ku analizohen çmimet, sasitë, verifikohen vleftat etj., në përputhje me kriteret e vlerësimit ekonomik. Përparësi në vlerësim do të kenë ofertat duke filluar me çmime më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin minimal të shitjes. Të gjithë konkurruesve të kualifikuar në fazën e parë, u lexohet dhe deklarohet emri dhe vlera e çdo oferte të dhënë.

Procesverbali i seancës të hapjes së zarfeve hartohet nga komisioni dhe një kopje e tij mund t'u vihet në dispozicion pjesëmarrësve në ankand.

Nuk do të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, me përjashtim të korigjimit të gabimeve aritmetike, për të cilat njoftohen menjëherë konkurruesit.

DSHP e rrethit _____ me pranimin e konkurruesit, do të korigjojë shumën totale të ofertës, e cila do të jetë e detyrueshme për ofertuesin.

Mospranimi i korigjimit është kusht skualifikues. Nëse gjatë vlerësimit rezulton se disa konkurrues kanë ofruar çmim dhe sasi të njëjtë me atë të një oferte fituese, me short do të vendoset fituesi i ofertës më të mirë. Shorti do të organizohet në prani të konkurruesve ose të përfaqësuesve të autorizuar të tyre, duke vendosur emrat e konkurruesve në një kuti dhe komisioni, pas tërheqjes së tyre, bën klasifikimin e konkurruesve.

Fituesi i ankandit do të njoftohet me shkrim, brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës, të lidhë kontratën ose të paguajë çmimin e shitjes. Në rast se fituesi refuzon ose nuk paraqitet brenda afatit të caktuar për lidhjen e kontratës, ose nuk paguan çmimin e shitjes, kjo dokumentohet dhe ai do të zëvendësohet me konkurruesin, oferta e të cilit është klasifikuar në renditje pas tij.

9. Dokumentet që konkurruesit në ankand duhet të paraqesin për fazën e vlerësimit paraprak.

a) Formulari i sigurimit të ofertës për ankand (origjinal).

b) Vendimi i gjykatës për fitimin e personalitetit juridik (për personat fizikë ose juridikë) (kopje e noterizuar).

c) Certifikata e regjistrimit në organin tatimor (për personat fizikë ose juridikë) (kopje e noterizuar).

d) Dokumentin identifikues për konkurruesit individë (letërnjoftim/pasaportë/dëshmi aftësie për drejtimin e automjetit (kopje e noterizuar e tyre) ose certifikatë origjinale me fotografi).

e) Mosparaqitja e ndonjërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.

10. Kriteri i vlerësimit ekonomik [3] [5]

Do të shpallet fituese oferta që ka çmimin më të lartë dhe që vlera e së cilës është më e madhe ose e barabartë me çmimin minimal të shitjes. Ofertat me çmim (vlerë) më të vogël se çmimi minimal i shitjes skualifikohen.

11. Mënyra e pagesës: Pagesa për mallin e shitur do të bëhet në lekë. [4] [6]

^[3] ^[5] Sipas rastit konkret të objektit të ankandit, komisioni mund të vendosë që të vlerësojë ofertën të ndarë sipas artikujve të nxjerrë për shitje.

^[4] ^[6] Mënyra, kushtet e pagesës, afatet dhe penalitetet për vonesën e pagesës vendosen sipas gjykimit të komisionit dhe sipas objektit konkret të shitjes.

FORMULARI I OFERTËS PËR ANKAND
(Për konkurruesit person fizik ose juridik)

_____, më _____.200_

_____ me seli në _____
(emërtimi i personit fizik ose juridik)(adresa e plotë)

pasi u njoh me dokumentet e ankandit që organizohet nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor për

shitjen e (lloji i mallit), duke pranuar plotësisht kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e këtij ankandi, ju paraqet ofertën e saj si më poshtë vijon:

Çmimi _____ për secilin mall (artikull)
(në numër dhe fjalë)

për sasinë e mallit (artikujve) _____
(në numër e fjalë)

dhe vleftën totale _____
(në numër e fjalë)

Vlefshmëria e kësaj oferte është _____ ditë.
(në numër e fjalë)

KONKURRUESI

(emërtimi i personit fizik ose juridik,
emri, mbiemri i titullarit, nënshkrimi, vula)

FORMULARI PËR SIGURIMIN E OFERTËS PËR PJESËMARRJE NË ANKAND

GARANCI BANKARE

Nr.ref. _____

Datë _____

Me të cilën vërtetojme se.....(emërtimi i subjektit) ka ngurtësuar, në llogarinë e tij, pranë Bankës (emërtimi i bankës), shumën prej (me shifra dhe me shkrim), si kusht për sigurimin e ofertës së paraqitur pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Rrethi _____ , për pjesëmarrje në ankandin e shitjes së asortimenteve të gatshme të lëndës drusore, që do të zhvillohet në datën_____.

Banka (emërtimi) merr përsipër të kalojë shumën e ngurtësuar në llogarinë e _____

_____ me nr. Llogarie _____ , në bankën _____ për llogari të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor _____ , në rast se:

1. pjesëmarrësi në ankand, i shpallur fitues, nuk lidh kontratë brenda afateve të Përcaktuara,
2. nuk paraqet garancinë bankare për sigurimin e kontratës.

Me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor _____ pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i një prej kushteve të mësipërme.

Banka (_____ emërtimi _____) çliron garancinë bankare vetëm mbas njoftimit me shkrim të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor _____ , për llogari të së cilës është ngurtësuar shuma e mësipërme.

Kjo garanci bankare është vlefeshme deri 20 ditë mbas datës së zhvillimit të ankandit.

(Emërtimi i bankës)

(Nënshkrimi dhe vula e Bankës)

FORMULARI PËR SIGURIMIN E KONTRATËS

GARANCI BANKARE

Nr. ref. _____

Datë _____

Për Drejtorinë e Shërbimit Pyjor

Duke qenë se:

(emërtimi i subjektit) në baze të kontratës nr. _____, datë _____ ka fituar të drejtën e _____ me vlefë totale (me shifra dhe shkrim) lekë, në kontratën tuaj është vendosur Garancia Bankare me shumën e specifikuar në të, si sigurim për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në atë kontratë.

(emërtimi i bankës) është dakord të lëshojë këtë garanci:

Deklarojmë se jemi garantuesit e kontratës së mësipërme deri në shumën totale prej (me

shifra dhe shkrim) lekë, shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë. Me marrjen e kërkesës së parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëni argumentim të kërkesës, ne marrim përsipër të paguajmë çdo shumë brenda kufirit prej (me shifra dhe shkrim) lekë, në llogarinë e _____, me nr.llogarie _____, në Bankën _____, për llogari të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Pyjor _____

Me këtë garanci ju sigurojmë se nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë (emërtimi i subjektit) për të realizuar pagesën sipas kërkesës së tij.

Deklarojmë gjithashtu, se asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të kontratës, për të cilën mund të bini dakord me kontraktuesin, nuk na çliron nga detyrimet e kësaj garancie.

Kjo garanci është e vlefshme deri në datën që përfshin 30 ditë, nga data e lëshimit nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor _____ e vërtetimit të përfundimit të kontratës.

(Emërtimi i bankës)

(Nënshkrimi dhe vula e Bankës)